



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA

USAID Compete Activity në Kosovë

Fondi i Konkurrueshmërisë Sektoriale

Deklarata Vjetore e Programit #4

Nr.: DVP-2023-04

- Lëshuar nga:** USAID Compete Activity në Kosovë.
- Data e lëshimit:** 4 dhjetor 2023.
- Data e mbylljes:** 1 gusht 2024, ora 15:00 CET.
Aplikacionet e hershme inkurajohen fuqimisht.
- Tema:** Ftesë për organizatat e përshtatshme të dorëzojnë Shprehjet e Interesit për financim partneriteti me qëllim të përmirësimit të konkurrueshmërisë sektoriale në eksport.
- Qëllimi:** Të merren propozime nga organizatat e përshtatshme përmes Shprehjes së Interesit për përmirësimin e konkurrueshmërisë eksportuese në sektorët e përpunimit të ushqimit, TIK-ut dhe përpunimit të drurit (përfshirë nënsektorin e shtëpive modulare/ndërtesave të parafabrikuara).
- Përshtatshmëria:** Organizatat e pranueshme përfshijnë organizatat e regjistruara ligjërisht në Kosovë dhe ato me seli në SHBA. Organizatat në vendet e treta mund të merren parasysh në baza individuale. Organizatat e përshtatshme për aplikim mund të jenë organizata jofitimprurëse, fitimprurëse dhe joqeveritare.
- Financimi:** Shumat e dhëna do të sillen nga 40,000 euro deri në maksimum 80,000 euro. Shumat nën 40,000 euro mund të merren parasysh në rrethana të justifikuara mirë dhe të jashtëzakonshme.
- Informimi:** Orari specifik i sesioneve informuese do të publikohet në Kosovo Export Network tek <https://www.facebook.com/KosovoExportNetwork>

INFORMACION I RËNDËSISHËM

USAID dhe Kosovo Compete Activity, dëshiron t'u sqarojë të gjitha palëve të interesuara se nuk ngarkon asnjë pagesë për aplikim në asnjë fazë të procesit të financimit. USAID dhe Kosovo Compete Activity **NUK** aprovojnë dhe nuk i japin përparësi asnjë konsulenti dhe i paralajmëron të gjithë aplikuesit që të kontrollojnë cilësinë e konsulentëve apo ofruesve të shërbimeve.

Nëse keni nevojë për më shumë informacion ose sqarime, ndjehuni të lirë të na kontaktoni në: kosovogrants@dt-global.com. Emaillet që kanë prapashtesën (domain) ndryshe prej @dt-global.com nuk janë të asociuara me projektin Kosovo Compete Activity.

Informacione të rëndësishme lidhur me etikën në DT Global

DT Global është e përkushtuar të ketë një kulturë të etikës, integritetit dhe drejtësisë ndaj të gjithë punonjësve dhe partnerëve. Linja etike e DT Global ofron një mundësi për të gjithë punonjësit dhe partnerët që në mënyrë konfidenciale dhe të sigurt, të ngrisin çfarëdo çështje ose dyshimi lidhur me ndonjë shkelje. Linja e etikës së DT Global, zbatohet nga një palë e tretë, në mënyrë që të ruhet besueshmëria e plotë për të gjithë raportuesit, duke i trajtuar me respekt raportimet. DT Global i përmbahet një politike të rreptë etike dhe vlerëson kontributin e secilit që raporton ndonjë dyshim për shkelje. Raportimet mund të bëhen përmes:

Uebfaqe: [ClearView Connects](#)

Email: speakup@coreintegrity.com.au

Adresa postare: PO Box 895, Darlinghurst NSW Australia 1300

Telefoni:

Australi: 1800 765 692

Spanjë: 900 998 400

SHBA: 1 (800) 203-7008

Shtet tjetër: +61 2 9053 9285

Detaje të mëtutjeshme:

[DT Global Code of Business Ethics and Conduct](#)

[DT Global Corruption Risk Management Statement](#)

1. Historiku i Projektit

USAID Kosovo Compete Activity (në tekstin e mëtejshëm: "USAID Compete", "Projekti" ose thjesht "Aktiviteti") financohet nga Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID-i). USAID Compete realizohet nga DT Global International Development. ("DT Global") si kontraktor kryesor, së bashku me Recura Financials dhe Canopy Lab si nënkontraktorë. USAID Compete është projekt pesëvjeçar që zgjat nga muaji gusht i vitit 2020 deri në muajin gusht të vitit 2025 dhe ka për qëllim të përmirësojë konkurrueshmërinë eksportuese të sektorëve kryesorë në Kosovë.

2. Sektorët Kryesorë

USAID Compete Activity përqendrohet në sektorët e mëposhtëm të orientuar drejt eksportit::

- Përpunimi i Drurit
- Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit (TIK)
- Përpunimi i ushqimit

Duke filluar nga viti 2022, USAID Compete ka zgjeruar gjithashtu mbështetjen e sektorit të drurit në **nënsektorin e shtëpive modulare/ndërtesave të parafabrikuara**.

3. Fushat e Përqendrimit

USAID Compete Activity përqendrohet në përmirësimin e konkurrueshmërisë eksportuese në tre sektorët kryesorë dhe në nënsektorin e shtëpive modulare/ndërtesave të parafabrikuara bazuar në pesë fusha:

- Qasja në Treg: Lehtësimi i lidhjeve të tregut ndërmjet ndërmarrjeve vendore dhe tregjeve rajonale/ndërkombëtare.
- Diversifikimi i Financimit: Mbështetja e zgjerimit të llojllojshmërisë së produkteve financiare të disponueshme për eksportuesit vendorë.
- Sofistikimi i Biznesit: Lehtësimi i përmirësimit të sistemeve, strukturave dhe mjeteve menaxheriale brenda kompanisë.
- Zhvillimi i Shkathtësive: Mbështetja e përmirësimit të ofrimit të shkathtësive relevante për industrinë.
- Mjedisi i Biznesit: Lehtësimi i përmirësimit të kapaciteteve të akterëve institucionalë përkatës, shoqatave dhe ofruesve të shërbimeve për të ofruar shërbime të përmirësuara.

4. Qasja Sistemike

Ka qenë praktikë e zakonshme që donatorët në Kosovë të ofrojnë financim dhe të mbështesin iniciativat që synojnë përmirësimin e konkurrueshmërisë së ndërmarrjeve ose entiteteve individuale. Megjithatë, kjo nuk është qasja e ndjekur nga USAID Compete. **Duhet të theksohet se USAID Compete nuk ofron financim dhe as nuk mbështet partneritete që synojnë përmirësimin e konkurrueshmërisë ose performancës së një biznesi të vetëm ose subjekti individual.** Megjithatë, USAID Compete do të punojë dhe do të mbështesë kompanitë individuale kur përmirësimi i performancës që rezulton do të ketë një ndikim më të gjerë në këtë sektor. Për shembull, blerja e makinerive për zgjerimin e prodhimit për një kompani të vetme nuk do të mbështetet.

Në vend të kësaj, USAID Compete ofron vetëm financim dhe mbështet iniciativat kur një ofertues ose aplikues dëshmon se aktivitetet e propozuara për financim do të kenë ndikim më të gjerë sistemik në sektorin përkatës. Mënyra se si aplikuesit duhet të kuptojnë “ndikimin sistemik” është nëse aktivitetet e tyre të propozuara për financim dëshmojnë përfitime që shkojnë përtej nivelit të një subjekti ose partneri. Propozimet e suksesshme nga aplikuesit duhet të japin një argument të qartë dhe të besueshëm në lidhje me natyrën e ndikimit sistemik të cilat do të rezultojnë nga partneriteti me USAID Compete.

Si shembull, nëse një biznes individual, dorëzon aplikacion për financim që kërkon të përmirësojë konkurrueshmërinë dhe rritjen e *vetëm asaj* kompanie të caktuar (pa ndikim tek sektori/ nën sektori ose akterët e tjerë të rëndësishëm të tregut, si p.sh. entitetet që kontribuojnë në zhvillimin e fuqisë punëtore ose importuesit e pajisjeve), atëherë ndikimi sistemik i këtij aplikacioni do të ishte i kufizuar dhe një propozim i tillë nuk do të finançohej. Megjithatë, nëse një kompani apo subjekt aplikues mund të argumentojë në mënyrë të besueshme që mbështetja e USAID Compete mund të ndikojë në mënyrën se si kompanitë e tjera ose partnerët e tjerë në sektor bëjnë biznes, krijojnë qasje në punëtorë të kualifikuar ose qasje në financa (për ti dhënë disa shembuj), atëherë iniciativa të tilla do të kishin ndikim sistemik më të madh në treg dhe kësaj do të kishin gjasa më të mëdha për t'u financuar.

Për t'i përcaktuar se sa *ndërhyrjet e propozuara* në kuadër të një aplikimi kanë ndikim *sistemik*, disa nga pyetjet e dobishme për të vlerësuar një aktivitetet e propozuara do të ishin si më poshtë (lista nuk është shteruese):

- A do të përfitojë nga një ndërhyrje e propozuar, një numër i madh akterësh/subjektesh/ndërmarrjesh, apo vetëm një akter/entitet/ndërmarrje?
- A do të ndikojë në ndryshimin e sjelljeve të një numri të madh akterësh? A do të përvetësojnë akterët e tjerë sjellje të reja?
- A do ta ndihmojë ndërhyrja e propozuar një partner të eksperimentojë me një produkt apo shërbim të ri?
- A do të ndihmojë ndërhyrja e propozuar në përhapjen e një norme të re të sjelljes konkurruese?
- A do t'u japë ndërhyrja e propozuar akterëve të tregut më shumë informacion rreth tregut në një mënyrë të qëndrueshme?

5. Qëllimi i Financimit

Përmes kësaj mundësie të financimit, USAID Compete fton aplikuesit të dorëzojnë propozime për financimin e ideve ose zgjidhjeve konkrete, që synojnë të përmirësojnë në mënyrë të qëndrueshme konkurrueshmërinë eksportuese të sektorëve të përpunimit të drurit, të përpunimit të ushqimit dhe të TIK-ut, si dhe nën sektorin e shtëpive modulare/ndërtesave të parafabrikuara.

USAID Compete inkurajon aplikuesit e interesuar për të siguruar fonde përmes këtij instrumenti të financimit që ta shohin këtë mundësi si diçka më shumë sesa thjeshtë marrje e një granti. Qëllimi i këtij financimi është të nxisë partneritetet ndërmjet USAID Compete dhe subjekteve të afta në kuadër të një aleancë për të rritur së bashku konkurrueshmërinë eksportuese të sektorit përkatës. Me fjalë të tjera, kjo mundësi e financimit është krijuar për të identifikuar partnerë të aftë që kanë njohuri dhe kapacitet për të identifikuar problemet dhe për të propozuar zgjidhje që synojnë qartësisht rritjen e konkurrueshmërisë eksportuese në tre sektorët kyç të USAID Compete si dhe nënsektorin e shtëpive modulare/ndërtesave të parafabrikuara.

6. Kufizimet e Sektorit

USAID Compete Activity ka identifikuar disa kufizime (shih: [Analiza Sistemit të Tregut dhe Kufizimeve](#)) të cilat e pengojnë konkurrueshmërinë eksportuese në sektorët e përpunimit të drurit, të përpunimit të ushqimit dhe të TIK-ut. Disa nga kufizimet kryesore përfshijnë:

- a) Sfidat e qasjes në treg, duke përfshirë promovimin e kufizuar të eksportit, brendimin e pamjaftueshëm dhe kanalet e kufizuara të shitjes.
- b) Produktet financiare joadekuate të dedikuara për kompanitë e orientuara drejt eksportit;
- c) Modelet e biznesit jo të zhvilluara sa duhet brenda kompanive, me struktura të dobëta të qeverisjes dhe menaxhimit.
- d) Qasje e kufizuar në fuqi punëtore të kualifikuara në përputhje me nevojat e industrisë.
- e) Mjedis i ambientit biznesor me mbështetje të kufizuar nga politikat publike joadekuate dhe kapacitete të kufizuara në institucionet publike dhe shoqatat e industrisë.

Aplikantët në këtë mundësi financimi duhet të demonstrojnë qartë se si propozimet e tyre për financim kërkojnë të adresojnë të paktën një kufizim të identifikuar të sistemit të tregut (jo ekskluzive për shembujt e listuar më sipër).

7. Rezultatet kryesore të dëshirueshme

Aplikacionet e dorëzuara në kuadër të kësaj thirrjeje duhet të demonstrojnë se si kërkesat e tyre për financim dhe aktivitetet e propozuara kontribuojnë në të paktën një nga treguesit e rezultateve më poshtë. Ndërsa aplikacionet vlerësohen nga këndvështrime të shumta, ato që tregojnë qartë potencial më të madh për ndikim në një ose mundësisht më shumë tregues të rezultateve (të gjithë të tjerët të barabartë) do të kenë një shans më të madh për të marrë fonde.

- Rritja e vlerës neto të eksporteve.
- Rritja e vlerës neto të shitjeve.
- Rritja e vlerës së investimit (privat ose publik).

- Rritja e numrit të lidhjeve të biznesit ndërmjet kompanive kosovare dhe blerësve ndërkombëtarë.
- Rritja e numrit të tregjeve të reja të eksportit në të cilat ka depërtim.
- Rritja e vendeve të punës, duke përfshirë gratë, të rinjtë dhe minoritetet.
- Rritja e numrit të individëve që përfundojnë trajnimet përkatëse për industrinë.
- Rritja e numrit të certifikatave përkatëse të marra të orientuara nga eksporti.
- Rritja e disponueshmërisë së opsioneve të financimit për kompanitë (financimi i eksportit, financimi i kapitalit, etj.).
- Rritja e digjitalizimit të kompanive.

8. Fushat prioritare për financim

Përmes kësaj thirrjeje financimi, USAID Compete mirëpret çdo aplikacion ndikues dhe inovativ që përmirëson qartë aftësinë konkurruese të eksportit në sektorët dhe nënsektorët ku përqendrohet USAID Compete; gjeneron ndryshime sistemike; dhe kontribuon në mënyrë të dukshme në treguesit e rezultateve të projektit të renditur më sipër.

Megjithatë, USAID Compete do t'i japë një shkallë të arsyeshme prioriteti financimit të propozimeve të paraqitura që avancojnë zbatimin e Planit të Punës të Vitit të 4 të projektit (PPV4). Prioritetet kryesore të PPV4-shit janë renditur më poshtë, të organizuara sipas fushave prioritare të projektit, pra qasjes në treg, financave të larmishme, sofistikimit të biznesit, zhvillimit të shkathtësive dhe mjedisit mbështetës të biznesit. Aplikacionet që sjellin përfitime për sektorin e shtëpive modulare/ndërtesave të parafabrikuara dhe në fushën e certifikimeve të produkteve dhe bizneseve do të konsiderohen në mënyrë të favorshme duke pasur parasysh prioritetet strategjike të USAID Compete.

Aplikacionet që përfshijnë lidhje të besueshme me bizneset e vogla në pronësi të minoriteteve dhe/ose grave do të merren parasysh në mënyrë të favorshme.

Qasja në treg

Aplikacionet në këtë fushë do të përqendrohen në lehtësimin e lidhjeve të tregut ndërmjet kompanive lokale dhe tregjeve rajonale/ndërkombëtare. Prioritetet kryesore përfshijnë, por nuk kufizohen në sa vijon:

- Mbështetja e lidhjeve të tregut të sektorëve të fokusit të Compete dhe zgjerimi i kanaleve të shitjeve të diasporës, rajonale dhe ndërkombëtare në tregjet ndërkombëtare të eksportit.
- Përmirësimi i qasjes së përpunuesve lokalë të ushqimit në bizneset e krijuara franshizë (HoReCa) në Kosovë dhe rrjetin e franshizave.
- Mbështetja e forcimit të aftësisë konkurruese të nënsektorit të shtëpive modulare/ndërtesave të parafabrikuara për të depërtuar në tregjet kryesore të eksportit.

Diversifikimi i Financave

Aplikacionet në këtë fushë do të përqendrohen në mbështetjen e diversifikimit të produkteve financiare të disponueshme për eksportuesit vendas. Prioritetet kryesore përfshijnë, por nuk kufizohen në sa vijon:

- Prezantimi dhe/ose diversifikimi i produkteve financiare të dedikuara për kompanitë e orientuara nga eksporti në sektorët prioritarë të Compete.
- Mbështetja e vazhdueshme për diversifikimin e produkteve financiare përmes futjes së faktoringut.

Sofistikimi i Biznesit

Aplikacionet në këtë fushë duhet të përqendrohen në lehtësimin e përmirësimit të sistemeve, strukturave dhe mjeteve të menaxheriale brenda kompanisë. Prioritetet kryesore përfshijnë, por nuk kufizohen në:

- Mbështetja e kompanive të orientuara nga eksporti për të digjitalizuar proceset e prodhimit dhe mbështetjes dhe për t'iu nënshtruar transformimit digjital.
- Mbështetja e sektorëve prioritarë të Compete për të miratuar certifikatat përkatëse në kuadër të mbështetjes së zinxhirëve të vlerës.

Zhvillimi i Shkathtësive

Aplikacionet në këtë fushë do të përqendrohen në mbështetjen e përmirësimit të ofrimit të aftësive të rëndësishme për industrinë. Prioritetet kryesore përfshijnë, por nuk kufizohen në sa vijon:

- Mbështetja e partneriteteve private të qendrave të trajnimit ose iniciativave në të tre sektorët dhe nënsektorët, për të futur programe dhe kurrikula inovative në teknologjitë dhe proceset e reja (duke përfshirë përmes zhvillimit të kurrikulave të trajnimit, Trajnimit të Trajnerëve (TT), promovimit dhe shtrirjes.

Mjedisi i Biznesit

Aplikacionet në këtë fushë do të përqendrohen në lehtësimin e përmirësimit të kapaciteteve të akterëve, shoqatave dhe ofruesve të shërbimeve përkatëse institucionale për të ofruar shërbime të përmirësuara. Prioritetet kryesore përfshijnë, por nuk kufizohen në sa vijon:

- Mbështetja e partnerëve lokalë për të ngritur dhe përmirësuar entitete certifikimi që mund të ofrojnë shërbime certifikimi për industritë lokale.
- Mbështetja e forcimit të nënsektorit të shtëpive modulare/ndërtesave të parafabrikuara përmes organizimit më të mirë dhe efektiv të sektorit.

Gratë dhe të Rinjtë

Aplikacionet në këtë fushë tematike do të përqendrohen në integrimin e grave dhe të rinjve në aktivitetet e konkurrueshmërisë sektoriale. Prioritetet kryesore përfshijnë, por nuk kufizohen në sa vijon:

- Mbështetja e partneriteteve për të lehtësuar transferimin e njohurive të diasporës për të përmirësuar lidhjet e eksportit dhe konkurrencën në mesin e pronareve gra të biznesit.
- Mbështetja e promovimit të karrierës në përpunimin e drurit, përpunimin e ushqimit, TIK-un dhe shtëpitë modulare/ndërtesat e parafabrikuara në mesin e grave dhe të rinjve.
- Mbështetjave e bizneseve në pronësi të grave në sektorët prioritarë të Compete për të hyrë në tregje të reja dhe për të rritur eksportet.
- Lehtësimi për gratë pronare të bizneseve që të kenë qasje më të lehtë në financa ose produkte alternative investimi, veçanërisht për të rritur konkurrencën dhe eksportet e tyre.

Diaspora

Aplikacionet në këtë fushë tematike do të përqendrohen në mobilizimin e potencialit të diasporës për rritjen e rritjen e konkurrueshmërisë eksportuese sektoriale në Kosovë. Prioritetet kryesore përfshijnë, por nuk kufizohen në:

- Lehtësimi i investimeve të diasporës në Kosovë.
- Lehtësimi i investimeve të përbashkëta ndërmjet diasporës dhe NVM-ve me bazë në Kosovë (bizneset ekzistuese dhe/ose ato të reja) në aktivitete të fokusuara në eksport.
- Përdorimi i rrjeteve të diasporës për zgjerimin e mundësive të rritjes përmes rrjedhës së rregullt të informacionit dhe promovimit të bashkëpunimit.

Minoritetet

Aplikacionet në këtë fushë tematike do të përqendrohen në integrimin e minoriteteve në aktivitetet e konkurrueshmërisë sektoriale. Prioritetet kryesore përfshijnë, por nuk kufizohen në sa vijon:

- Mbështetja e lidhjeve të tregut të bizneseve në pronësi të minoriteteve brenda Kosovës dhe me tregjet e eksportit.
- Lehtësimi i kanaleve të shitjes së eksportit për përpunuesit në shkallë të vogël të Kosovës në pronësi të minoriteteve.
- Përmirësimi i qasjes së përpunuesve lokalë në pronësi të minoriteteve në bizneset e themeluara të franshizave (HoReCa) në Kosovë dhe në rrjetin e franshizave.
- Lehtësimi i ofrimit të mbështetjes për kompanitë në pronësi të minoriteteve për certifikatat e domosdoshme të lidhura me aftësinë konkurruese të eksportit.
- Përmirësimi i përfshirjes së kompanive dhe stafit në pronësi të minoriteteve në ndërhyrjet që lidhen me fuqinë punëtore.
- Promovimi i karrierës në përpunimin e drurit, përpunimin e ushqimit, TIK-un dhe shtëpitë modulare/ndërtesat e parafabrikuara në mesin minoriteteve, me fokus në AAP-të publike/private.

9. Fusha të tjera për financim

Siç u theksua, USAID Compete do të jetë gjithashtu i hapur për shqyrtimin dhe vlerësimin e propozimeve të tjera që janë jashtë fushave kryesore prioritare të listuara më sipër. USAID

Compete do të ofrojë një mundësi për aplikantët e mundshëm, partnerët dhe palët e tjera të interesit që të paraqesin ide të financueshme që janë inovative dhe me ndikim, dhe në përputhje me objektivin e përgjithshëm të projektit për të përmirësuar aftësinë konkurruese të sektorit privat dhe eksportit në sektorët prioritarë të përpunimit të drurit, përpunimit të ushqimit, TIK-ut dhe shtëpive modulare/ndërtesave të parafabrikuara. Në rastin e *aktiviteteve të lidhura me diasporën*, USAID Compete do të jetë i hapur për rishikim dhe financim (në baza individuale) të propozimeve inovatore, të qëndrueshme dhe me ndikim që mund të bien jashtë sektorëve dhe nënsektorëve prioritarë të projektit .

10. Madhësia e Grantit

Në varësi të disponueshmërisë së fondeve, fondet në kuadër të kësaj mundësie financimi pritet të sillen:

- 40,000 euro deri në 80,000 euro.
- Mund të merret parasysh edhe financimi nën 40,000 euro në rrethana të veçanta dhe të arsyetuara mirë.

Periudha e zbatimit të aktiviteteve të financuara është maksimumi 1 vit.

11. Financimi i pranueshëm dhe jo i pranueshëm

Lista e kostove që USAID Compete do të mbulonte dhe nuk do të mbulonte në një aplikacion të suksesshëm financimi (të organizuar sipas llojit të partnerit) është si më poshtë:

Lloji i partnerit	USAID Compete do të paguajë për	USAID Compete <u>NUK</u> do të paguajë për
<i>Akterët e Sektorit Privat (duke përfshirë bizneset, ndërmarrjet e konsulencës, etj.)</i>	<ul style="list-style-type: none"> • Zhvillimi i modelit të biznesit • Zhvillimi i produktit/shërbimit • Promovimi ndërkombëtar 	<ul style="list-style-type: none"> • Pajisjet • Kostot e ndërtimit • Udhëtimi dhe akomodimi • Shpenzimet e vazhdueshme (overhead)
<i>Shoqatat e Industrisë dhe Odat e Biznesit</i>	<ul style="list-style-type: none"> • Mbulimi i kostos së Personelit për një periudhë të caktuar kohore, pas së cilës shoqata e bartë vetë koston • Kostot lidhur me aktivitete të veçanta programatike 	<ul style="list-style-type: none"> • Udhëtimi dhe akomodimi për anëtarët • Kostot e ndërtimit • Pajisjet • Shpenzimet e vazhdueshme (overhead)
<i>Zhvilluesit e fuqisë punëtore</i>	<ul style="list-style-type: none"> • Pajisjet (të vlerësuara në baza individuale) • Zhvillimi i kurrikulës 	<ul style="list-style-type: none"> • Kostot e ndërtimit • Shpenzimet e vazhdueshme (overhead) • Udhëtimi dhe akomodimi

	<ul style="list-style-type: none"> • Certifikatat e njohura nga industria • Kostot e tjera fikse të zhvillimit të ofertave të trajnimit • Subvencionimi i tarifave të trajnimit nëse ka një plan të besueshëm për ofrimin e trajnimit pa subvencionim në të ardhmen, ose përqendrohet te gratë dhe pakicat 	<ul style="list-style-type: none"> • Akreditimi nga institucionet publike
--	---	--

12. Pranueshmëria dhe Përshtatshmëria e Aplikuesve

Të gjitha grantet që jepen nga USAID Compete Activity do t'u nënshtrohen kritereve të pranueshmërisë që janë paraqitur më poshtë. Organizatat e përshtatshme duhet të jenë:

- Subjekte, institucione ose organizata të regjistruara sipas ligjit dhe me seli në Kosovë apo ShBA. Organizatat në vendet e treta mund të merren në konsideratë në baza individuale.
- Organizatat jofitimprurëse/OJQ-të, shoqatat dhe odat e biznesit, agjencitë e zhvillimit rajonal, institucionet arsimore publike (institutet, shërbimet e zgjerimit, etj.) ose organizatat tregtare dhe/ose fitimprurëse që kuptojnë se asnjë fitim ose tarifë nuk do të lejohet sipas marrëveshjes së grantit.

Organizatat e përshtatshme/pranueshme po ashtu duhet të:

- Të dëshmojnë aftësinë për të kontribuar në objektivat e USAID Compete dhe për ta realizuar grantin sipas parimeve dhe praktikave të USAID-it dhe DT Global International Development.
- Të dëshmojë një menaxhim të shëndoshë financiar, administrativ dhe teknik në formën e një sistemi kontrollesh që mbron asetet dhe mbron nga mashtrimi dhe shpërdorimi.
- Kenë një histori të performancës së kënaqshme dhe histori të integritetit dhe etikës së biznesit.
- Të jenë në gjendje të vërtetojnë dhe të nënshkruajnë të gjitha certifikatat e detyrueshme (të renditura në **Shtojcën A**).

Organizatat e papërshtatshme/papranueshme përfshijnë:

- Individët.
- Partitë ose institucionet politike.
- Organizatat që avokojnë, promovojnë apo përkrahin politika antidemokratike apo veprimtari të paligjshme.
- Organizatat që synojnë të përdorin fondet për synime fetare.
- Subjektet që kanë keqpërdorur fondet e USAID-it në të kaluarën.
- Subjektet që janë në listën e palëve të përjashtuara nga programet federale të prokurimit

dhe jo-prokurimit apo të Komitetit për Sanksione të Sigurisë së Kombeve të Bashkuara ose që kanë pronarë ose menaxherë që janë të përjashtuar në këtë mënyrë.

Para dhënies së një granti në kuadër të kësaj mundësie financimi (DVP), aplikantëve të suksesshëm do t'u kërkohet të nënshkruajnë një Vërtetim në Lidhje me Financimin e Terrorizmit ku vërtetohet se organizata e aplikuesit nuk u jep dhe nuk u ka dhënë kurrë ndihmë terroristëve për aktivitete terroriste. Nga aplikuesit e suksesshëm gjithashtu mund të kërkohet që të nënshkruajnë vërtetime të tjera të zbatueshme për grantin. Vërtetimet janë bashkangjitur si **shtojca A** e kësaj DVP-je.

Para dhënies së një granti në kuadër të kësaj DVP-je, aplikantët e suksesshëm do t'i nënshtrohen gjithashtu një *përcaktimi të përgjegjësisë para dhënies*, i cili do të kryhet nga USAID Compete. Gjatë këtij përcaktimi, USAID Compete Activity do të përcaktojë nëse aplikuesi e ka kapacitetin organizativ, kapacitetin financiar, kontrollet e brendshme, sistemet e prokurimit (nëse kërkohen) dhe evidenca të performancës së tij në të kaluarën për t'i realizuar me sukses aktivitetet e grantit. Vetëm organizatat që përcaktohet se janë të përgjegjshme do të jenë të përshtatshme për dhënie të grantit.

Nuk do të merren parasysh aktivitetet që kanë një ndikim negativ mjedisor që nuk mund të zbutet.

13. Ndarja e kostos

Aplikantët inkurajohen fuqimisht të ndajnë të paktën disa nga kostot e zbatimit të aktiviteteve të projektit të propozuar. Aplikantët që nuk propozojnë asnjë pjesë të kostos nuk do të vlerësohen në mënyrë të favorshme. Aplikantët që propozojnë pjesë të konsiderueshme të kostos do të kenë pikë shtesë në vlerësimin e aplikacioneve të tyre.

Përfituesit e grantit inkurajohen të japin kontribute në mallra megjithatë, duke qenë se ato nuk përfshijnë shpenzime në para për grantmarrësit, ato nuk do të trajtohen si bashkëfinancim. Kontributi “në mallra” përfaqëson investimin e bërë në formën e mallrave dhe shërbimeve, dhe jo në para të gatshme.

14. Procesi i aplikimit

Kjo mundësi financimi do të ketë një proces prej disa fazash të aplikimit dhe vlerësimit. Gjatë secilës fazë të aplikimit, duke përfshirë edhe fazën para aplikimit, USAID Compete mund të bashkëveprojë e bashkëkrijojë me aplikuesit, ku mund të punojë bashkë me aplikuesit potencialë dhe aplikuesit e tjerë, me qëllim të sigurimit që propozimet e tyre të kenë ndikim më të madh dhe të jenë më shumë në harmoni me objektivat e USAID Compete. *Fushëveprimi i plotë i këtij bashkëveprimi dhe bashkëkrijimi ndërmjet USAID Compete dhe aplikuesve është përshkruar në pjesën 16 më poshtë.*

Faza 1: Dorëzimi i Shprehjes së Interesit (Koncept Nota)

Gjatë fazës së parë, aplikantëve u kërkohet të dorëzojnë një Shprehje të Interesit (ShEI) që përmbledh deklaratën e problemit që synohet të trajtohet, ndërlidhjen e aktiviteteve të

propozuara me qëllimet e USAID Compete, përshkrimin e aktiviteteve dhe detyrave kryesore të propozuara, ndikimin e pritshëm sistemik, rezultatet e pritura (duke përshkruar mënyrën se si rezultatet kontribuojnë në treguesit e rezultateve të projektit), një plan menaxhimi, përvojën e mëparshme përkatëse të aplikantit dhe një buxhet fillestar të propozuar. Shprehja e interesit duhet të shpjegojë qartë dhe përmbledhtazi qëllimin e aktivitetit të propozuar të grantit, rëndësinë, aktivitetet dhe rezultatet e pritshme në mbështetje të objektivave të USAID Compete siç janë përcaktuar në këtë kërkesë. Të gjitha shprehjet e interesit duhet të dorëzohen në formatin e dhënë në **Shtojcën B** të kësaj thirrjeje dhe nuk duhet të tejkalojnë 5 faqe.

ShEI-të mund t'i dorëzohen USAID Compete në çdo kohë para datës dhe kohës së mbylljes siç është saktësuar në këtë ftesë.. **Megjithatë, aplikacionet e hershme inkurajohen fuqimisht.** Aplikuesit duhet t'ia dorëzojnë ShEI-të me shkrim Menaxherit të Granteve dhe Nënkontratave të USAID Compete në mënyrë elektronike, përmes postës elektronike në kosovogrants@dt-global.com. Data e fundit për dorëzimin e ShEI-ve është **1 gusht 2024** dhe koha e mbylljes për dorëzimin e shprehjeve të interesit është ora 15:00 sipas kohës lokale të Kosovës (Koha e Evropës Qendrore, CET) më atë datë. ShEI-të që dorëzohen pas kësaj date dhe kohe nuk do të merren parasysh sipas kësaj DVP-je.

USAID Compete do ta mbledhë një Komision për Përzgjedhje të Granteve (KPG) që do t'i vlerësojë ShEI-të e dorëzuara si përgjigje ndaj kësaj ftese në vazhden e arritjes së tyre. ShEI-të do të vlerësohen duke u bazuar në kriteret që janë përfshirë më poshtë (shih Seksionin 14). Nëse ShEI-ja e ndonjërit aplikues pranohet nga KPG-ja, aplikuesi do të ftohet që ta dorëzojë një Aplikim të Plotë për Grant siç është detajuar më poshtë.

Faza 2: Dorëzimi i Aplikacionit të Plotë për Grant

Pas vlerësimit të shprehjeve të interesit, USAID Compete do të ftojë organizatat që kanë dorëzuar shprehje të interesit të suksesshme që të dorëzojnë një aplikacion të plotë për grant (APG) bazuar në konceptin dhe qasjen teknike të propozuar në shprehjen e interesit. Të gjitha aplikacionet duhet të dorëzohen në Formatin e Aplikacionit të Plotë për Grant të përfshirë në **Shtojcën C** të kësaj kërkesë. Formatin e APG-së kërkon që aplikantët të zgjerohen në detaje mbi aktivitetin e propozuar të grantit, objektivat, ndikimin sistemik dhe rezultatet e pritshme, duke përfshirë një përshkrim të përfituesve të synuar dhe palëve të interesit, strukturën e propozuar të personelit dhe buxhetin e hollësishëm të grantit. Aplikacioni i plotë për grant nuk duhet të tejkalojë 15 faqe. Aplikacionet mbi 15 faqe nuk mund të shqyrtohen nga USAID Compete Activity.

15. Vlerësimi dhe Përzgjedhja

USAID Compete do të formojë Komitetin për Përzgjedhjen e Granteve i cili do të shqyrtojë në mënyrë të vazhdueshme Shprehjet e Interesit dhe APG të dorëzuara në përgjigje të kësaj thirrjeje. KPG-ja do t'i vlerësojë Shprehjet e Interesit dhe APG në bazë të këtyre kriterëve:

Kriteret e Vlerësimit	Pyetjet kryesore të vlerësimit	Pikët
1. <u>Relevanca Ndaj Objektivave të USAID Compete</u>	A janë aktiviteti i propozuar i grantit, qëllimet dhe objektivat në përputhje me objektivat e USAID Compete (d.t.th., për të përmirësuar në mënyrë të	10

	qëndrueshme aftësinë konkurruese të eksporteve të sektorit privat në tre sektorët prioritarë?)	
	Deri në çfarë mase aktiviteti, qëllimet dhe objektivat e propozuara të grantit kontribuojnë në arritjen e synimeve dhe objektivave të USAID Compete siç janë përcaktuar në këtë kërkesë?	
2. <u>Shkalla në të Cilën Aplikimi Adreson Kufizimet e Sektorit</u>	Deri në çfarë mase është i lidhur aktiviteti i propozuar me kufizimet sektoriale të USAID Compete në Sistemin e Tregut dhe Analizën e Kufizimeve ?	10
	A demonstroi aplikanti një kuptim të qartë të problemeve/çështjeve kryesore që do të adresojë aktiviteti i propozuar i grantit dhe si lidhet ai me kufizimet e identifikuara të sektorit?	
3. <u>Shkalla në të Cilën Aplikimi Sjell Ndikim Sistemik</u>	A ka gjasa që veprimi të sjellë përfitime për një numër të madh akterësh të tjerë apo shumica e përfitimit do t'i mbetet partnerit?	20
	A është e besueshme që partneri do të vazhdojë me këtë veprim në të ardhmen pa mbështetjen e USAID Compete?	
	Kush e 'bën' veprimin e propozuar aktualisht dhe kush 'pagan' për këtë veprim aktualisht? Kush do ta bëjë veprimin e propozuar në të ardhmen dhe kush do të paguajë për veprimin e propozuar në të ardhmen?	
	A do ta ndihmojë veprimi një partner të eksperimentojë me një produkt apo shërbim të ri, apo tregu për këtë produkt apo shërbim tashmë është i vendosur mirë në Kosovë?	
4. <u>Ndikimi dhe Rezultatet</u>	Cilat janë rezultatet e synuara të aktivitetit të propozuar të grantit?	20
	Në cilin tregues të rezultateve kyçe të USAID Compete kontribuon aktiviteti i propozuar (siç lidhet me pjesën 7 të kësaj kërkesë)?	
	A kontribuon aktiviteti i propozuar në më shumë se një tregues të rezultateve dhe cili është ndikimi i pritur?	
5. <u>Cilësia e aplikacionit të dorëzuar</u>	A është i deklaruar qartë dhe i arritshëm qëllimi i përgjithshëm i aktivitetit të propozuar të grantit?	10
	A propozon aplikanti aktivitete specifike që janë logjike, reale dhe të rëndësishme për qëllimin e aktivitetit të grantit?	
	A është e qartë se si arritja e qëllimit të përgjithshëm të	

	aktivitetit të grantit dhe objektivave specifike do të kontribuojë në zgjidhjen e çështjeve/sfidave kryesore?	
	A është ideja e propozuar inovative dhe e re në treg?	
	A ka aktiviteti i propozuar pas vetes një model biznesi të fortë/solid?	
	Si i mbështesin aktivitetet e propozuara gratë, të rinjtë dhe minoritetet?	
	A do të kenë aktivitetet e propozuara ndikim negativ të rëndësishëm në mjedis?	
<u>6. Kapaciteti i aplikantit dhe përvoja e kaluar</u>	A ka organizata përvojë përkatëse në të kaluarën në zbatimin e aktiviteteve të ngjashme?	15
	A ka aplikanti burime të mjaftueshme njerëzore, teknike, menaxheriale dhe burime të tjera në dispozicion për të zbatuar me sukses aktivitetin e propozuar?	
	A konsiderohet aplikanti mirë brenda sektorit për sa i përket gatishmërisë së tij për të kryer aktivitetin e propozuar?	
<u>Efektiviteti i kostos dhe Bashkëfinancimi</u>	Çfarë burimesh janë siguruar për kostot e propozuara?	15
	A është buxheti i propozuar realist, i menduar mirë dhe në përputhje me aktivitetet e propozuara?	
	Çfarë niveli të bashkëfinancimit propozon organizata/aplikuesi?	
	A është bashkëfinancimi domethënës karshi arritjes së objektivave të aktivitetit?	
	A është propozimi i aplikuesit për bashkëfinancim nga ana e vetë dhe palëve të tjera përveç USAID Compete, i besueshëm dhe i arritshëm?	
	A janë kostot e propozuara të arsyeshme, të lejueshme dhe të alokuara për grantin?	
Gjithsej		100

Nëse KPG-ja pranon shprehje të interesit bazuar në kriteret e mësipërme, USAID Compete do ta njoftojë aplikantin me shkrim dhe do ta ftojë organizatën të dorëzojë një Aplikacion të Plotë për grant. Afati i fundit për APG-të do t'i komunikohet aplikantit të suksesshëm pas njoftimit se shprehja e interesit është pranuar. KPG-ja do të vlerësojë APG-në bazuar në kriteret e listuara më sipër.

USAID Compete rezervon të drejtën për ta financuar cilëndo apo për të mos e financuar asnjërën nga aplikimet e paraqitura. Lëshimi i këtij ftese për grante nuk përbën zotim për dhënie të grantit

nga ana e USAID Compete Activity, as nuk e obligon Compete që të paguajë për shpenzimet e bëra gjatë përgatitjes dhe dorëzimit të ndonjë ShEI-je apo aplikimi të plotë për grant. Veç kësaj, USAID Compete rezervon të drejtën që ta refuzojë cilëndo apo të gjitha aplikimet e marra nëse ai veprim konsiderohet se është në interesin më të mirë të qeverisë së ShBA-ve. Aplikuesi e bartë rrezikun e dorëzimit të aplikacionit; nëse rrethanat e pamundësojnë dhënien e grantit, të gjitha shpenzimet e përgatitjes dhe dorëzimit janë në barrë të aplikuesit.

16. Bashkë-krijimi me aplikantët

Siç u përmend, në këtë mundësi financimi (DVP), USAID Compete do të përdorë një sistem të konkurrimit me shumë faza. Objektivat e konkurrimit të përbërë prej disa fazash janë si vijon:

- a) Të shqyrtohen paraprakisht qasjet, metodologjitë dhe objektivat teknike të aktiviteteve të propozuara të grantit për të përcaktuar nëse ato janë në përputhje me objektivat e USAID Compete Activity dhe do të kontribuojnë në arritjen e rezultateve të projektit.
- b) Të dëshmohet që aplikanti zotëron aftësitë teknike dhe përvojën e nevojshme për të kryer aktivitetet dhe për të kontribuar drejt objektivave USAID Compete.
- c) Të sigurohet efikasiteti në mënyrë që përfituesit e pakualifikuar të grantit ose përfituesit e granteve që propozojnë koncepte ose qasje për grante që nuk janë në përputhje me objektivat e projektit, të mos humbasin burimet përmes përgatitjes së një Aplikacioni të Plotë për grant.

Në përputhje me procesin e aplikimit të përshkruar në pjesën 14 të këtij dokumenti, USAID Compete do të bashkëkrijojë në mënyrë aktive dhe të ngushtë aktivitete dhe propozime me aplikantët e mundshëm. Kjo mund të përfshijë bashkëkrijimin një-më-një ose me shumë aplikantë dhe mund të ndodhë në faza të ndryshme të procesit të aplikimit siç përshkruhet në pjesën 14. Bashkëkrijimi është një praktikë e lejuar brenda projekteve të USAID-it me qëllim të përmirësimit të cilësisë së ndërhyrjeve bazuar në një bashkëpunim proaktiv ndërmjet financuesit dhe zbatuesve të mundshëm.

Për më tepër, bashkëkrijimi ofron hapësirën e nevojshme ndërmjet USAID Compete dhe aplikantëve potencialë për të inkorporuar kontributin e sektorit privat dhe akterëve të tjerë të rëndësishëm në procesin e identifikimit të problemeve dhe propozimit të zgjidhjeve. Nëpërmjet bashkëkrijimit, USAID Compete mund të vërtetojë dhe të zërthejë më tej kufizimet që pengojnë aftësinë konkurruese të sektorit përmes përpjekjeve të përbashkëta bashkëpunuese me partnerët e interesuar. Bashkëkrijimi mund të çojë gjithashtu në një kuptim të përmirësuar të interesave dhe objektivave të partnerit, duke përmirësuar kështu pranimin përmbajtësor.

Për të maksimizuar kontributin dhe bashkëpunimin thelbësor në hartimin e propozimeve të suksesshme, procesi i mësipërm i bashkëkrijimit do të karakterizohet nga një komunikim i gjerë dhe gjithëpërfshirës ndërmjet USAID Compete, sektorit privat, partnerëve të mundshëm zbatues dhe partnerëve të tjerë të mundshëm, si subjektet përkatëse qeveritare dhe joqeveritare. Përmes bashkëkrijimit, USAID Compete mund të ketë diskutime të forta dhe të detajuara me partnerët përkatës gjatë gjithë procesit, që nga angazhimi i hershëm me akterët kryesorë për qasjet dhe zgjidhjet e mundshme përpara paraqitjes së një koncepti, deri te përsosja e mëtejshme dhe zhvillimi i vazhdueshëm i koncepteve të paraqitura dhe aplikacioneve të plota deri te hartimi përfundimtar dhe negocimin e marrëveshjeve ose granteve.

Siç është përshkruar në pjesën 14 të këtij dokumenti, procesi i konkurrimit i USAID Compete përfshin dorëzimin e Shprehjeve të Interesit ose Koncept Notave nga aplikantët, të cilat nëse miratohen, pasohen nga dorëzimi i Aplikacionit të Plotë për Grant. Bashkëkrijimi nga USAID Compete do t'i mundësojë projektin të angazhohet me aplikantët e mundshëm në çdo fazë të procesit të aplikimit, duke përfshirë edhe gjatë para-aplikimit, në formën e sesioneve të "brainstorming" me partnerët rreth ideve të mundshme të ndërhyrjes që mund të financohen nga DVP-ja.

Për shembull, edhe para se partnerët të dorëzojnë një Shprehje Interesi, USAID Compete mund të angazhohet dhe të eksplorojë me partnerë potencialë për të kuptuar qëllimet dhe interesat e tyre, për të identifikuar sfidat dhe zgjidhjet dhe për të eksploruar ekspertizën përkatëse duke përfshirë burimet dhe aftësitë. Këto angazhime mund të ndihmojnë USAID Compete dhe partnerët të fillojnë formulimin e ndërhyrjeve, aktiviteteve dhe qasjeve të mundshme. Angazhimi para aplikimit me partnerët mund të jetë i nevojshëm për të kuptuar më mirë sfidat specifike me të cilat përballet një sektor dhe akterët e tij dhe për të eksploruar rrugët për zbatimin e ndryshimeve sistematike.

Pasi të dorëzohet një *Shprehje e Interesit* (koncept notë), USAID Compete mund të kontaktojë me aplikantët për sqarime ose informacione shtesë. Ai gjithashtu mund të planifikojë takime pune për të shqyrtuar qasjen e propozuar dhe për të ndryshuar propozimin për të përmirësuar ndikimin e tij kundrejt objektivave të projektit për të arritur një ndikim të dëshiruar sistematik. Gjatë kësaj faze, USAID Compete dhe partnerët mund të angazhohen në diskutime shumë më të detajuara dhe të plota për të përcaktuar dhe rafinuar së bashku aktivitete specifike dhe për të specifikuar rolet e partnerëve.

Përveç kësaj, pasi të dorëzohet një *Aplikacion i Plotë për Grant*, USAID Compete mund të vazhdojë angazhimin me aplikantët për të ndërtuar, zhvilluar dhe përmirësuar më tej qasjen e përgjithshme dhe aktivitetet e propozuara. Gjatë kësaj faze, nuk do të ishte e pazakontë, nëpërmjet një procesi shumë bashkëpunues të bashkëkrijimit, që idetë dhe aktivitetet e paraqitura fillimisht në fazën e konceptit të evoluojnë ndjeshëm, pasi partnerët përsosin qasjet e tyre në mënyrë që të identifikojnë mënyrën më të mirë për të arritur rezultatet më të mëdha. Për më tepër, në fazën e dorëzimit të shprehjeve të interesit/koncept notës ose në fazën e APG-ve, partnerët mund të përcaktojnë që subjekte të tjera duhet të përfshihen në ndërhyrjen e propozuar. Çelësi është që të përqendroheni në ndërtimin e një kuptimi të përbashkët të sfidave, problemeve dhe mundësive që duhen adresuar dhe në përcaktimin e mënyrave më të mira për ta bërë këtë.

Duke u angazhuar në bashkëkrijim, USAID Compete do të sigurojë gjithashtu se ekzistojnë masa mbrojtëse strikte për të shmangur sfidat e konfliktit të interesit. Përkatësisht, USAID Compete do të sigurojë që për asnjë subjekt të mos krijohet asnjë avantazh i padrejtë konkurrues. USAID Compete do të përpiqet në masën maksimale të mundshme për të siguruar që të gjithë partnerët e mundshëm zbatues të kenë qasje në informacion të barabartë. Nëse ndonjë informacion jopublik zbulohet gjatë bashkëkrijimit, kjo do të bëhet me mirëkuptimin e akterëve të përfshirë që i njëjti informacion duhet të vihet në dispozicion të të gjitha palëve të interesit që dëshirojnë të aplikojnë. USAID Compete gjithashtu do të sigurojë që të gjithë aplikantëve t'u ofrohet një shans i barabartë, pavarësisht nga pjesëmarrja e tyre në diskutimet e bashkëkrijimit me projektin.


17. Zbutja e Shtrebbërimin të Tregut

USAID Compete do të sigurojë procedura të qarta, transparente dhe konkurruese për grantet e financuara nga projekti, ku aspektet kryesore përfshijnë: rezultatet e pritura, shtrebbërimin e tregut dhe ndarjen e kostos. Propozimet për grante do të vlerësohen dhe miratohen me synimin për të shmangur shtrebbërimin e tregut ose për të favorizuar një prodhues, grup biznesi ose interes mbi një tjetër.

Në përmirësimin e aftësisë konkurruese të një sektori, nënsektori ose grupi ndërmarrjesh të caktuar, grantet do të nxisin një fushë loje të barabartë për kompanitë konkurruese dhe plotësuese në të njëjtin zinxhir vlerash. Qëllimi i programit të granteve të USAID Compete nuk është që të përdoret si financim i drejtpërdrejtë ose ofrimi i subvencioneve për organizatat prodhuese, por për të avancuar aftësinë konkurruese brenda zinxhirëve të vlerës së synuar të USAID Compete. Fondi nuk do të përdoret për të ofruar subvencione të padrejta që konkurrojnë me institucionet financiare ekzistuese. Fondi do të strukturohet dhe menaxhohet për të siguruar që ai të mos shtrebbërojë tregun vendas.

Kriteret kryesore për rishikimin dhe miratimin e granteve do të jenë përfitimet e pritura sasore dhe cilësore për sektorin, nën-sektorin ose grupin e ndërmarrjeve, duke përfshirë vlerësimet e arsyeshme të rritjes së shitjeve, eksporteve dhe punësimit që do të gjenerohen në krahasim me koston totale të aktivitetit dhe ndarjen e propozuar të kostos. Të gjitha grantet, dhe në veçanti ato për kompanitë fitimprurëse, do të përfshijnë dispozita të përshtatshme për të siguruar që të ardhurat e programit të përdoren për të çuar më tej objektivat e pranueshme të programit.

18. Aplikimi për Grant, Vlerësimi dhe Zbatimi¹



¹ Përgjatë rrjedhës së aplikimit të paraqitur këtu, do të zbatohet bashkë-krijimi nga USAID Compete me aplikantë potencialë dhe në dukje të suksesshëm, në përputhje me dhe siç përshkruhet në Seksionin 16.

19. Administrimi i fondeve

Në bazë të 2 CFR 200 Nën pjesa E dhe 2 CFR 700.13, është politikë e USAID-it që të mos e lejojë profitin në kuadër të instrumenteve të asistencës. Megjithatë, të gjitha shpenzimet e arsyeshme, të ndara dhe të lejueshme, direkte dhe indirekte, të cilat lidhen me aktivitetin e grantit dhe janë në përputhje me standardet e aplikueshme të kostos (2 CFR 200 Nën pjesa E për organizatat jofitimprurëse dhe institucionet arsimore, dhe Blerja Federale Rregullorja (FAR) Pjesa 31.2 për organizatat fitimprurëse), mund të paguhet në kuadër të grantit.

Çdo dhënie e grantit pastaj do t'u nënshtrohet afateve dhe kushteve të Kontratës Kryesore për USAID Compete Activity.

1. Shtojcat

- A. Vërtetimet, Garancitë dhe Deklaratat e Tjera të Ofertuesve
- B. Format i Shprehjes së Interesit
- C. Aplikimi i Plotë për Grant²

² Shtojca C përbëhet nga formulari i aplikacionit të plotë për grant (formati Word) dhe formulari i buxhetit (formati Excel).